



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 29 Tetor 2015, merr këtë

V E N D I M

I.

I APROVOHET ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" sh.a. subvencioni në shumë prej 10,000.00 Euro.

II.

OBLIGOHET Drejtoria për Pronë dhe Financa që shumën e theksuar në pikën e parë të këtij vendimi të i'a bartë ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" sh.a..

III.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Ndërmarrja publike lokale "Trafiku Urban" sh.a. është duke u ballafaquar me probleme të vazhdueshme financiare. Si rezultat i gjendjes së tillë financiare, është duke u rrezikuar funksionimi i rregullt i kësaj ndërmarrje. Prandaj është bërë e domosdoshme që kësaj Ndërmarrje të i ndahet subvencioni në shumën prej 10000 Euro, me qëllim që Ndërmarrja të i shlyej obligimet e saj ndaj kreditorëve.

Andaj, duke u bazuar në nenin 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

I DORËZOHET:

- NPL "Trafiku Urban" sh.a.,
- Drejtorisë për Pronë dhe Financa, dhe
- Qendrës për shërbime me qytetar.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti